



VOTA IME VENDIMI IM!

Analizë e problemit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjerit



Qendra për hulumtim dhe
krijim të politikave



E përkrahur nga
Programi për
Zhvillim i Kombeve
të Bashkuara



Neni 22 - Kushtetuta e R.M.

E drejta për zgjedhje është e njejtë, e përgjithshme dhe direkte, realizohet në zgjedhje me votim të fshehtë

VOTA IME VENDIMI IM!

Analizë e problemit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjerit

Botues:

Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave

Rr: Cico Popoviq 6-2/9 1000, Shkup

Tel/faks +389 3109932

www.crpm.org.mk | crpm@crpm.org.mk

Analiza është pregaditur nga ekipi i ekspertëve të Qendrës për Hulumtim dhe Krijim të Politikave

Titulli i analizës është i marrur nga fushata e quajtur “Voto ime - vendimi im !”

Redaktor i botimit dhe koordinator i fushatës

Riste Zmejkoski

Autor:

Sanja Kostovska

Ana Mickovska

Dimitar Nikollovski

Në bashkëpunim me :

Gjunere Nebiu

Dizajni dhe pregaditja teknike

Stefan Nikollovski | stefannikolovski@yahoo.com

Komentet dhe sygjerimet në lidhje me këtë studijim dërgoni në adresën

e-mail: crpm@crpm.org.mk

Tirazh - 500

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	7
2. KORNIZA LIGJORE	8
3. PREZANTIM I PROBLEMIT NGA ANA E MEDIAVE	10
3.1. Prezantim i problemit nga ana e mediave në gjuhën maqedonase	10
3.2. Prezantim i problemit nga ana e mediave në gjuhën shqipe	11
4. VËSHTRIM METODOLOGJIK I HULUMTIMIT	14
5. ANALIZË E FENOMENEVE TË VOTIMIT FAMILJAR DHE VOTIMIT NË EMËR TË TJETRIT	16
5.1. Vështrim i problemit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit përmes prizmës së qytetarëve	16
5.1.1. Interesim për politikë/zgjedhje ndërmjet burrave dhe grave	16
5.1.2. Ndikim mbi vendimin për cilin të votohet	18
5.1.3. Diskutim në familje dhe ndërtim i qëndrimit	19
5.1.4. Votim i njëjtë/i ndryshëm nga anëtarët e tjerë të familjes	22
5.1.5. Votim në emër të tjetrit	23
5.1.6. Njohja e rregulloreve ligjore	24
5.1.7. Mendime për arsyet e këtyre fenomeneve	25
5.2. Vështrim i problemit të votimit familjar përmes prizmës së përfaqësuesve të institucioneve shtetërore	27
5.2.1. Problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit nga aspekti i KOZ - së dhe këshillat zgjedhore	27
5.2.2. Problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit nga aspekti i deputeteve	31
6. REKOMANDIME	34
7. PËRFUNDIM	36

1

HYRJJE

Problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit është fenomen i cili është karakteristikë e patejkalueshme e procesit zgjedhor maqedonas. Megjithatë, strategji konkrete për zgjidhjen dhe çrrënjosjen e këtij problemi ende nuk ekziston. Edhe pse bëhet fjalë për problem aktual, që është në qendër të vëmendjes gjatë çdo ciklit zgjedhor, deri më tani nuk është bërë analizë e bazuar në të dhëna primare për përcaktimin e zgjedhjes efektive dhe të qëndrueshme të këtij problemi. Pa perspektivë të këitillë është rëndë edhe për vetë institucionet të përgatisin strategji relevante e cila saktësisht do t'i përcaktoi grupet e caktuara, si dhe mënyrën e çrrënjosjes së problemit. Analizat ekzistuese të cilat e trajtojnë këtë pyetje e shqyrtojnë vetëm kuadrin ligjor, ndërsa mungon hulumtimi cilësor për arsyet e problemit.

Analiza e përgatitur prej Qendrës për hulumtim dhe krijim të politikave-QHKP në partneritet me iniciativën qytetare të grave - Antiko jep një perspektivë të re të problemit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit. Qëllimi është të dilet nga korniza e shqyrtimit stereotip të këtij problemi, i cili nuk është i bazuar në fakte. Për këtë qëllim, mbi bazën e kornizës së përgjithshme metodologjike të përgatitur nga QHKP, analiza e përgatitur jep vështrim të shkurtër të kuadrës ligjore lidhur me këtë problem, por i prezanton edhe shkaqet kryesore, anët përgjegjëse, problemet dhe zgjidhjet për mënyrën në të cilën ata janë të perceptuara nga ana e qytetarëve të interesuar dhe institucioneve relevante.

Kjo analizë paraqet bazë të dobishme mbi të cilën do të mundet të definohet strategji e qartë dhe precize për çrrënjosjen e këtij problemi.

2

KORNIZA LIGJORE

Me Kushtetutën e RM garantohet e **drejta zgjedhore e barabartë**, e përgjithshme dhe e drejtpërdrejtë, e cila mundësohet në **zgjedhje të lira me votim në mënyrë të fshehtë** (neni 22). Këto principe të së drejtës zgjedhore janë të përsëritura në kontekst me zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale (neni 62 dhe 80).

Me kodin zgjedhor është definuar detajisht e drejta ligjore. Sipas ligjit¹ Komisioni qendror i zgjedhjeve është organi përgjegjës për kontrollim të vendeve zgjedhore ku janë të paraqitura parregullësi gjatë zgjedhjeve, ndërmjet të cilave dhe votimi familjar dhe në emër të tjetrit (neni 31). Rol kryesor në procesin e sigurimit të kushteve të përshtatshme të praktikës së pandërprerë të së drejtës zgjedhore kanë Komisioni komunal i zgjedhjeve dhe Këshilli zgjedhor (KZ). Përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit zgjedhor është veçanërisht e madhe duke pasur parasysh se ata janë në kontakt të drejtpërdrejtë me votuesit në vetë vendin e zgjedhjes. Në këtë drejtim edhe kodi ligjor si kompetencë e KZ-së e imponon obligimin të “siguroj rregullësi dhe votim të fshehtë”, si dhe “votim të lirë dhe të qetë” (neni 40).

Votimi familjar dhe votimi në emër të tjetrit janë veprime joligjore të cilët i thyejnë parimet e garantuara me Kushtetutë për të drejtën zgjedhore. Në atë drejtim, “shkelja e fshetësisë së votimit”, e cila implikon votim familjar dhe votim në emër të tjetrit përmes urdhëresës “ndonjë person ose persona kanë votuar për të tjerë” janë të paraqitura si bazë për anulimin e votimeve (neni 151).

Kodi zgjedhor bën përjashtim, përkatësisht ndihmon gjatë votimit në rast se “votuesi ka ndonjë të metë fizike ose është analfabet [...] nuk mundet të votoj në mënyrë të përcaktuar me këtë kod” (neni 112). Edhe pse kodi zgjedhor i ka definuar detalisht kushtet në të cilat votuesi mund të bazohet

¹ Kodi ligjor, Gazeta zyrtare e R.M., 31.03.2006

në këtë të drejtë, mjerisht ky nen shumë herë është i keqpërdorur për qëllime të ndryshme, përkatësisht për votim familjar.²

Kodi zgjedhor dhe kodi penal parashikojnë gjykitje në rast të kundërvajtjes, lëndimit dhe keqpërdorimit të së drejtës ligjore. Kodi zgjedhor parashikon gjykitje për kundërvajtje në rast kur “personi fizik voton për më shumë persona ose voton në emër të tjetrit” (neni 191). Kodi zgjedhor³ përmban urdhëresa me të cilat me të holla ose me burgim deri një vit, përkatësisht deri gjashtë muaj, dënohet votimi në emër të tjetrit, përkatësisht lëndim i votimit të fshehtë (neni 161 dhe neni 163).

2 Prof. dr. Renata Treneska-Deskoska, Një votues-një votë. Ta ndalojmë votimin familjar dhe votimin në emër të tjetrit, UNDP, 2008

3 Gazeta zyrtare e R.M., nr.19 më 30.03.2004

3

PREZANTIM I PROBLEMIT NGA ANA E MEDIAVE

3.1 Prezantim i problemit nga ana e mediave në gjuhën maqedonase

Mediat maqedonase nuk merren shumë me problemin e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit. Zakonisht ky fenomen në mediat vetëm përmendet pas zgjedhjeve, mirëpo vetëm regjistrohet pa analizë të thelluar të shkaktarëve dhe strategji të mundshme për rrugëdalje. Në rastet kur mediat mundohen t'i gjejnë shkaqet për këtë dukuri, zakonisht këndvështrimi vendoset në pikëpamjet stereotipe se çdo gjë anon kah mentaliteti i grupeve të caktuara të qytetarëve, zakonisht individ të paarsimuar prej komuniteteve rurale të myslimanëve.

Praktika që kreu i familjes të voton edhe për gruan ose edhe për anëtarë tjerë të familjes është pjesë e traditës e cila në Maqedoni vështirë largohet. Prej saj janë të goditura më pak të arsimuarit ose gratë ekonomisht të varura dhe kryesisht ndodh në vendet rurale.⁴

Potencohet dominimi i burrit ndaj vendimeve të gruas, përmes transmetimit të deklaratave të grave: *“Në ditën e zgjedhjeve mbetem në shtëpi, ndërsa bashkëshorti voton për mua, sepse sipas traditës vendi i gruas është në shtëpi dhe në fushë. Politika është punë e burrave.”⁵;*

4 BBC Macedonian: 2 dhjetorë, 2008, “Si kundër “votimit familjar”

5 Dnevnik, 20 mars, 2006, “Kur kushtetuta thotë një, ndërsa tradita krejtësisht tjetër”

Dhe burrat: *“Nuk ka asnjë problem, të gjithë votojmë, por unë ju them do të votoni për ata që unë do të ua tregoi dhe ashtu duhet të jetë, sqaron banori i fshatit Kamenjan të Tetovës.”*⁶

Familjarisht votojmë sepse ashtu duhet. E shoqja ndoshta ka të drejtë vetë të zgjedh, por çka kupton ajo nga politika që të din se për cilin të voton, thotë një banor i fshatit Glumovë të Shkupit.⁷

Problemi zakonisht është i shqyrtuar si karakteristikë e më shumë përfaqësuesve të kësaj bashkësie, me çka stereotipet përforcohen. Qëndrime të kundërshtueshme të këtyre janë rrallë të paraqitura dhe zakonisht prezantohen me skepticizëm. Bile edhe në artikujt që kanë të bëjnë me rrjedhën e fushatës “Një votues-një votë” së UNDP-së kundër votimit familjar potencohen qëndrimet stereotipe, ndërsa analiza kritike shumë herë anashkalohej”.

Në deklaratat e mediave, nga ana e numrit më të madh të protagonistëve (organizata joqeveritare, parti etj.), si përgjegjës për këtë dukuri përmenden këshillat zgjedhore. Manipulimet e mundshme nga ana e partive përmenden shumë rrallë, megjithatë nuk potencohen si shkatarr/motivues serioz i votimit familjar dhe i votimit në emër të tjetrit. Poashtu, shumë rrallë përmenden edhe gjobitjet për votim familjar.

3.2 Prezantim i problemit nga ana e mediave në gjuhën shqipe

Mediat në gjuhën shqipe shumë pak e trajtojnë pyetjen rreth votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit. Shumë rrallë mund të haset titull i veçantë, artikull ose koment lidhur me këtë problematikë në shtypin ditor në gjuhën shqipe.

Kjo tematikë më shumë është e përfshirë në shënimet gazetareske gjatë Zgjedhjeve parlamentare 2008, në pjesën ku transmetohen informatat e dhëna nga KQZ-ja, MOST ose misionet ndërkombëtare lidhur me rezultatet zgjedhore, parregullsitë, anulimi i votimeve. Në atë kontekst, për votimin familjar dhe votimin në emër të tjetrit, flitet si për pjesë të parregullësive të evidentuara ose si një nga shkaqet për anulim të zgjedhjeve.⁸

6 Ibid.

7 Dnevnik, 27 maj, 2008, Votimi familjar traditë apo keqpërdorim

8 shiko: www.shkupi.com [15.06.2008], AlsatM [4.06.2008], TV Gurra

Analiza e përmbajtjes rezultoi me numër shumë të vogël të titujve dhe artikujve të cilat janë veçanërisht të dedikuara dhe kanë qasje analitike ndaj trajtimit të këtij fenomeni. Në arkivin e Alsat - M, gjenden 44 tituj të cilat janë të lidhura me zgjedhjet, proceset zgjedhore, rezultatet, parregullsitë dhe në pjesën më të madhe të tyre votimi familjar është i përfshirë me 3-4 fjalë. Nuk është gjetur informatë në të cilën flitet se votimi familjar është shkaku i vetëm për anulimin e votimit.

Hulumtimi rezultoi me vetëm tre tituj të cilët i janë dedikuar votimit familjar. Në artikullin e parë - "Votimi familjar është i pranishëm në trupin zgjedhor shqiptarë"⁹, transmetohen qëndrimet e disa përfaqësuesve të partive politike, ndër të cilët edhe përfaqësuesja e një partie politike e cila thotë: "Çdo herë na iritojnë raportet ku përsëritet se familjet shqiptare votojnë në mënyrë familjare. Ne kemi dëshmuar para të gjithëve edhe para misioneve mbikqyrëse ndërkombëtare se dimë të votojmë." Megjithatë, gazetari ose redaksia nuk jep komentin e vetë në lidhje me këtë fenomen të votimit familjar.

Në artikullin tjetër, të marrë nga MIA, është prezantuar diskutimi i tryezës së rumbullakët për ndalimin e votimit familjar në organizim të UN-DP-së, ku thuhet se në ndalimin e votimit familjar rol shumë të rëndësishëm kanë partitë politike.

Përfundimisht, vetëm në një rast është hasur në intervistë, transmetuar nga agjencia YLL PRESS¹⁰ - "Votimi i fshehtë është e drejtë e palënduar", me ekspert të UN në zgjedhje. Intervista në pjesën më të madhe i është dedikuar fenomenit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit.

Mundet të konkludohet se mediat në gjuhën shqipe i japin shumë pak kujdes kësaj teme, kryesisht i transmetojnë informatat e marrura prej institucioneve të cilat i mbikqyrin zgjedhjet, ndërsa nuk kanë kontribute, komente dhe qëndrime të veta lidhur me këtë pyetje. Problemi trajtohet pamjaftueshëm, veçanërisht në periudhën parazgjedhore. Si rezultat, këto fenomene nuk kanë mundësi të arrijnë te publiku, i cili nuk është mjaft i njohur me shkaqet për këto dukuri dhe shpeshherë nuk i trajton si kërcnim për rregullsitë e zgjedhjeve.

9 www.alsat-m.com [15.11.2008]

10 www.yllpress.com (11.10.2008), thuhet se intervista është marrë nga gazeta "Fakti"

4


VËSHTRIM METODOLOGJIK I HULUMTIMIT

Për qëllimet e analizave janë zbatuar 14 fokus-grupe, nga dy në secilën prej komunave në vijim nga e para, e dyta dhe njësjia e gjashtë zgjedhore: Haraçinë, Saraj, Çelopek, Likovë, Tearcë, Radiovcë dhe Shuto Orizare. Zgjedhja e komunave është bërë sipas të dhënave të misioneve mbikqyrëse për raste të vërejtura të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, gjatë zgjedhjeve të kaluara (2006 dhe 2008). Përkatësia etnike e pjesëmarrësve ishte në përpjestim me përkatësinë e shumicës së popullsisë në komunat e përmendura, d.m.th. në komunën e Shuto Orizares, pjesëmarrësit ishin romë, ndërsa në komunat tjera me përkatësi etnike shqiptare.

Në fokus-grupet morrën pjesë gjithsej 120 persona, prej të cilëve 51 burra dhe 69 gra. Diskutimet me burrat dhe gratë u mbajtën të ndara, me qëllim të nxiten përgjigje të sinqerta dhe të mundësohet shqyrtim i problemit nga aspekti i gjinisë.


Karakteristikat demografike të pjesëmarrësve janë të dhëna në grafikonet si më poshtë.

Grafikon 1. Pjesëmarrës në fokus grupet sipas gjinisë dhe moshës



Mund të vërehet se qëllimi ishte të jenë të përfaqësuar më shumë votues të rinj dhe numër më i madh i femrave.

Grafikon 2. Pjesëmarrës në fokus grupet sipas gjinisë dhe statutit të punës



Me qëllim të fitohen mendime nga faktorë të ndryshëm relevant në lidhje me praktikat e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, janë intervistuar dhe

- 3 femra - deputete,
- 1 përfaqësues i Komisionit qendror të zgjedhjeve (KQZ), dhe
- 3 anëtarë të këshillave zgjedhore

5

ANALIZË E FENOMENEVE TË VOTIMIT FAMILJAR DHE VOTIMIT NË EMËR TË TJETRIT

Analiza është bërë në bazë të dhënave të marrura nga qytetarët e anketuar, si dhe mendimet e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, partive politike dhe këshillave zgjedhore.

5.1 Vështrim i problemit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit përmes prizmës së qytetarëve

Pjesa më e madhe e analizës është e bazuar në përgjigjet e marrura nga fokus grupet të organizuara në shtatë komunat ku janë vërejtur raste të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit. Theksi është vënë në përvojat e qytetarëve me këto fenomene, mënyrat se si i kuptojnë, qëndrimet e tyre në lidhje me ato, qëndrimet dhe përvojat e qytetarëve tjerë të komunave të tyre, njohja e rregulloreve, si dhe ndikimi i faktorëve të ndryshëm mbi sjelljen e vendimeve për cilin të votohet.¹¹

5.1.1 Interesim për politikë/zgjedhje ndërmjet burrave dhe grave

Ndonëse numri më i madh i pjesëmarrësve në fokus-grupin dhanë përgjigjen se rregullisht votojnë në zgjedhje, ndërmjet burrave dhe grave, është vërejtur dallim në pikëpamjet e interesimit për ngjarjet politike. Pothuajse të gjithë burrat u përgjigjën se i ndjekin fushatat zgjedhore, duke dhënë arsye të ndryshme për interesimin e tyre:

11 Citatet që janë dhënë në tekstin më poshtë janë zgjedhur për ilustrim të mendimeve që dominojnë te fokus grupet.

I ndjek sepse më intereson se si planifikojnë të na gënjejnë.

I ndjek fushatat, mendoj se kjo gjë më nevojitet si qytetar. Rregullisht votoj pa marrë parasysh, këtu nuk ka dilemë.

Po rregullisht i shikoi këto ngjarje në televizion, sepse jam i detyruar ta bëj këtë gjë në kohën kur ka zgjedhje.

Për dallim nga ata, numër më i vogël i grave i ndjekin ngjarjet politike. Mund të nxjerret konkludimi se gratë më të reja më pak i ndjekin ngjarjet politike, edhe pse ka përjashtime. Megjithatë, edhe ato të cilat rregullisht ndjekin ngjarje politike, atë e bëjnë vetëm në kohë të zgjedhjeve ose kur në emisionet politike ka disa të ftuar aktual dhe interesant. Përshtypja e përgjithshme është se besimi në politikanët dhe premtimet e tyre është shumë i ulët, gjë që nxit revolt tek pjesëmarrësit.

Në televizion nuk shikoi programe politike, sepse më nervozojnë politikanët. Për mua është vetëm humbje kohe t'i dëgjoj kur gënjejnë. Kur ka emisione të tilla e ndroj kanalin televiziv; shikoi diçka tjetër që do të ndjehem më këndshëm.

Një numër i madh i grave deklaruan se fare nuk duan ti ndjekin ngjarjet gjatë kohës së zgjedhjeve.

Kur ka fushata zgjedhore dal prej dhomës dhe derisa zgjasin ato, bëj diçka tjetër.

Këtu te ne, për shembull, edhe mos të duash ti ndjekish, vetë ambienti të shtyen ti ndjekish ato ngjarje, posaçërisht kur është koha e zgjedhjeve. Ngado që të kthehesh flitet dhe dëgjohet për politikë, edhe në mediat gjithnjë ka programe të paguara politike dhe asgjë tjetër nuk ka në televizion.

Ndonëse ndërmjet femrave ekziston interesimi për ngjarjet politike, ai është shumë më i vogël se interesimin që e tregojnë meshkujt. Poashtu, vërehet se ato janë më të ndieshme ndaj parregullësive, të cilat ndodhin në politikë që ndikon mbi interesin e tyre për ndjekjen e ngjarjeve politike.

5.1.2 Ndikim mbi vendimin për cilin të votohet

Faktorë të ndryshëm mund të ndikojnë në formimin e vendimit se për cilin të votohet në zgjedhje. Përveç fushatave politike që janë të caktuara për ta formuar mendimin e votuesit; edhe ndikimi nga ana e rrethinës (miqë, farestë, fqinjë) mund të jetë shumë i madh. Në këtë aspekt nuk ishin të vërejtura dallime ndërmjet meshkujve dhe femrave në lidhje me ndikimet që këta faktorë i kanë mbi vendimin e tyre përfundimtar.

Pjesa dërmuese e të anketuarve meshkuj u përgjigjën se fushata nuk ndikon në vendimin e tyre për cilin do të votojnë. Në të shumtën e rasteve, prej më parë e kanë sjellë atë vendim, ose thjesht nuk besojnë në atë që flitet gjatë fushatave.

Ndjekja e fushatave nuk ndikon mbi atë se për cilën parti do të kisha votuar. Unë, personalisht përcaktimin tim e kam bërë para një kohe ashtu që fushata nuk do të ndikon mbi sjelljen e vendimit tim.

Atë çka mundem unë ta konstatoj si qytetar është se partitë nuk rrinë pas fjalëve të premtuara gjatë fushatave.

Vetëm tre veta thanë se ka ndikim fushata, prej të cilëve te njëri ndikon vetëm pjesërisht.

I ndjek fushatat - mendoj se kjo gjë më nevojitet si qytetar. Rregullisht votoj, këtu nuk ka dilemë. Mendoj se fushatat janë pa cilësi në lidhje me atë çka është ofruar dhe çka realizohet. Por prapëseprapë fushata është momenti kur unë vendosi për cilin do të votoj sepse nuk kam burim tjetër të informimit.

Mendimin se për cilin do të votoj e formoj në bazë të fushatave. Në rast se ndonjë nga ofertat programike më tërheq, pa dyshim do të votoj për atë parti politike.

Ngjashëm me këtë, edhe shumica e femrave janë të mendimit se fushatat nuk iu kanë ndikuar në vendimin për cilin të votojnë. Të gjitha të anketuarat thanë se as bisedat me miqtë nuk ndikojnë në vendimin për cilin të votojnë. Pjesa dërmuese e din prej më parë se për cilin do të votoj, varësisht nga historiku i partisë, ose kush është në pushtet, ose çka është punuar/çka ndodhur.

Një numër i vogël i të anketuarve meshkuj thonë se bisedat me miqtë vetëm deri diku ju ndikojnë në vendimin se për cilin të votojnë ose vetëm i përforcojnë qëndrimet e tyre të arritura më parë.

Nuk mundem të them se bisedat me kolegët dhe miqtë e mi bëjnë që unë të vendosi për cilin do të votoja, por ato janë shumë ndikuese për përforcimin e qëndrimeve të mia ndaj asaj partie.

Megjithatë, shumica thotë se ky është vendimi i tyre, edhe pse të tjerët janë munduar t'ju ndikojnë, nuk e kanë arritur atë ose thjesht nuk duan të flasin për këto tema me miqtë.

Sipas përgjigjeve të marrura, mund të konkludohet se perceptimi i të anketuarve është se fushatat politike dhe bisedat me miqtë dhe fqinjët nuk ndikojnë ose shumë pak ndikojnë mbi formimin e vendimit përfundimtar për votim të meshkujt dhe të femrat.

5.1.3 Diskutim në familje dhe ndërtim i qëndrimit

Pjesa më e madhe e të anketuarve u përgjigjën se bisedojnë për politikë në gjirin familjar, dhe për dallim të faktorëve të mëparshëm, këto diskutime kanë ndikim më të madh në formimin e qëndrimit të tyre në lidhje me vendimet.

Femrat shprehën qëndrime të ndryshme në lidhje me pyetjen a bisedohet në familjen e tyre për mënyrën se si të votohet në zgjedhje. Numri më i madh i të anketuarave, posaçërisht më të rejtat dhe më të arsimuarat, marrin pjesë në diskutimet shtëpiake se për cilin të votohet.

Tani është kohë tjetër - edhe meshkujt edhe femrat diskutojnë për politikë.

Te unë në shtëpi kur diskutohet për ndonjë temë politike shumë dua të më dëgjojnë kur jap ndonjë mendim ose kritikë, posaçërisht babai im i cili e respektton mendimin tim.

Megjithatë, një pjesë e atyre që diskutojnë thonë se edhe pse marrin pjesë në diskutimet, në fund meshkujt e sjellin atë vendim.

Anëtarët meshkuj tek unë më së shumti diskutojnë, ne gratë vetëm ndonjëherë inkuadrohemi në bisedat për ato tema, dhe votojmë ashtu siç bëjmë marrëveshje me ato.

Numër më i vogël i të anketuarave thanë se nuk duan të diskutojnë, sepse nuk kanë interesim për politikë ose për shkak se bashkëshortët/baballarët e tyre mendojnë se politika nuk është për femra.

Në familjen time babai im më së shumti diskuton për cilën parti të votohet, ndërsa ne të tjerët vetëm e dëgjojmë dhe nuk komentojmë për këtë. Sipas tij gratë nuk duhet të inkuadrohen në politikë dhe mendoj se edhe nëse them mendimin tim nuk do të më kishte dëgjuar, as respektuar atë. Ne e njohim atë dhe që të mos vij deri në konflikt dakordohemi me te edhe pse nuk ka të drejtë.

Te unë në shtëpi anëtarët tjerë të familjes bisedojnë për cilën parti të votohet, por unë nuk inkuadrohem në bisedën. Dal nga dhoma dhe nuk diskutoj për këtë.

Më shumë se gjysma e grave ishin në mendim se tërë familja nuk ka nevojë të votoj për të njëjtën parti ose për të njëjtin kandidat, dhe thonë se çdo njëri ka mendimin e vet dhe të drejtën e vet për të sjellë vendim.

Ne në shtëpi asnjëherë nuk bisedojmë për cilin parti ose kandidat do të votojmë - çdo njëri ka mendimin dhe të drejtën e vet.

Posaçërisht kur janë zgjedhjet flitet për politikë te ne, debatohet për kandidatët, ndonjëherë edhe unë ndërlihem në bisedën dhe e respektojmë mendimin tim, por në fund vetë vendosim se për cilin do të votojmë.

Përjashtim nga ky konstatim janë gratë e Tearcës dhe Sarajit, ku të gjitha janë të njëzëshme se e tërë familja duhet të votoj për një kandidat ose parti, për shkak të dobisë të drejtpërdrejtë të cilën mund ta ketë familja.

Unë mendoj se e tërë familja duhet të votoj për kandidat të njëjtë, sepse nëse për shembull në zgjedhje fiton kandidati im ose partia ime, atëherë kjo është e dobishme për të gjithë anëtarët e familjes - do të ketë më shumë punësime.

Po e rëndësishme është deri diku, nëse një anëtar i familjes ka interes nga ajo parti sigurisht e tërë familja mund të ketë përfitim.

Qëndrimet e të anketuarve meshkuj ishin më rigjide se sa të femrave. Edhe pse gjysma e tyre thanë se lejojnë që gratë të flasin për politikë dhe për cilin të votohet, gjysma tjetër mendon se burrat duhet ta kenë fjalën përfundimare për përcaktimin, që është në kundërshtim me konstatimet e

mëparshme se çdo person është i lirë të vendos se për cilin do ta jep votën e vet. Si shkaqe kryesore për qëndrimin e tyre cekën faktorët e mosinteresimit dhe arsimimi i pamjaftueshëm të femrat.

Tek unë në shtëpi burrat vendosin, gratë vetë nuk shfaqin interesim për këtë. Zakonisht më shumë vendosin burrat. Nuk do ta përdorja fjalën diskriminim, por do të thoja se në familjen time gratë janë të paarsimuara, ndërsa burrat janë me shkallë më të lartë të arsimimit në krahasim me ato. Ashtu që gjatë vendimit mendoi se burrat kanë më shumë ndikim.

Megjithatë, është thënë se femrat më të reja, posaçërisht ato më të arsimuarat i ndjekin këto procese, komentojnë në shtëpi dhe vetë vendosin.

Jam baba i vajzës e cila ka mbaruar fakultet, ajo i ndjek dhe i lexon këto procese, është më e informuar se unë dhe këtu s'kam çka të përzihem.

Nëse më pyetni për bijat e mija sigurisht që po. Unë personalisht nuk jam aq i shkolluar si ato. Informatat që ato i kanë janë më të mëdha se informatat e mia.

Dihet, kjo është pjesë e realitetit tonë, për atë për të cilin unë do të votoj zakonisht voton e tërë familja. Ndërsa, gjatë periudhës parazgjedhore të gjithë komentojnë. Pikërisht, me bijat e mija më së shumti sepse ato kanë shkollim të lartë, ato komentojnë, analizojnë, ndërsa me bashkëshorten e cila ka shkollë tetëvjeçare nuk diskutoj për këto tema. Bashkëshortet mundemi në ndonjë mënyrë ti bindim, sepse ato nuk ja të arsimuara, nuk kanë informata të mjaftueshme, por vajzat ose ata që janë të arsimuar - këtu bindja nuk vjen në shprehje.

Mundet të përmbledhet se qëndrimi i shumicës së burrave është, se gratë nëse janë të arsimuara munden vetë të sjellin vendime të drejta se për cilin të votojnë në zgjedhje, mirëpo femrat me shkollim më të ulët nuk munden të sjellin vendim të drejtë dhe për atë shkak duhet t'ju sygjerohet nga ana e anëtarëve meshkuj të familjes. Ndryshe nga ata, femrat nuk bëjnë dallim të madh ndërmjet qytetarëve me shkallë të ndryshme të shkollimit, në lidhje me aftësitë e tyre për sjelljen e vendimeve.

5.1.4 Votim i njëjtë/i ndryshëm nga anëtarët e tjerë të familjes

Ndonëse një pjesë e madhe e të anketuarave u përgjigjën se vetë vendosin se për cilin të votojnë: “Nuk ka nevojë burri të më tregoi për cilin të votoj, ajo është e drejta ime dhe mendimi im”; megjithatë mendimi i familjes te një pjesë e tyre është vendimtar:

Unë derisa isha te babai votoja sipas asaj siç na thoshte ai për cilin të votojmë, por kur u martova votoja ndryshe nga bashkëshorti, sepse tek ai ishin prej partisë tjetër. Kjo gjë aspak nuk është pasqyruar në marrëdhëniet tona familjare dhe deri më tani asnjëherë nuk jemi shamatosur.

Të gjitha të anketuarat nga Saraj dhe Tearca, si dhe një pjesë e Shuto Orizares, thanë se votojnë për të njëjtin kandidat ose parti si kreu i familjes (d.m.th. bashkëshortët, baballarët). Disa thanë se nëse votojnë ndryshe, bashkëshorti mund të divorcohet prej tyre.

Nëse i kundërshtoi burrit dhe nuk pajtohem me vendimin e tij, do të hidhërohet dhe do të divorcohet nga unë.

Megjithatë, janë të vetëdijshme se duhet vetë të shkojnë dhe të votojnë dhe se ekziston konsensus absolut kundër votimit familjar.

Mendoj se më nuk ekziston mundësia të votojmë për tërë familjen dhe e dijmë se kjo gjë është e ndaluar dhe gjobitet; votimet asnjëherë nuk zhvillohen në atë mënyrë, sepse vetë karakteri i votës është personal (personalisht) dhe jo grupor.

Afro gjysma e të anketuarve meshkuj thanë se anëtarët femra të familjes votojnë sipas instrukcioneve të tyre.

Asplotisht siç do të them unë, ashtu do të votohet. Sigurisht do të isha hidhëruar nëse ajo vepron ndryshe nga ajo siç jemi marrë vesh në shtëpi

Megjithatë, derisa për pjesën më të madhe nuk do të kishte pasur problem nëse anëtarët e familjes votojnë ndryshe nga ato, një pjesë (ndër të cilët prijnë të anketuarit nga Tearca) të cilët mënjanohej nga tendenca e përgjithshme, u përgjigjën se do të hidhëroheshin nëse anëtarët e familjes

nuk i respektojnë sygjerimet e tyre se për cilin të votojnë. Një i anketuar nga Likova u përgjigj se:

Nuk do të hidhërohesha, por do t'i kisha sygjeruar që herën tjetër të më konsulton.

5.1.5 Votim në emër të tjetrit

Të anketuarit ndjeheshin të padisponuar të flasin për raste të votimit në emër të tjetrit. Pothuajse të gjithë u përgjigjën se nuk ju ka ndodhur dikush të voton në emër të tyre, por një pjesë njohin raste të tilla. Një grua nga Radiovca tha:

Nga fqinjët e babit tim dëgjova se një njeri i ka marrë të gjitha dokumentet e anëtarëve të familjes dhe ka shkuar të voton për të gjithë, por anëtarët e këshillit zgjedhor nuk e kanë lejuar.

Të anketuarat e Shuto Orizares ishin më të sinqerta të flasin për këtë temë. Njëra prej tyre tha se personalisht i ka ndodhur që dikush të votoj në vend të saj, por kur e ka vërejtur këtë dhe ka reaguuar e kanë përjashtuar nga vendvotimi. Të tjerë kanë dëgjuar për raste kur dikujt i kanë ofruar paga që të lejon dikend tjetër të votoj në vendin e tij. Shembuj të votimit në emër të tjetrit në Shuto Orizare ju kanë ndodhur edhe një numri të madh të femrave analfabete.

Pjesa më e madhe e të anketuarave shfaqti mendim negativ për atë që dikush tjetër të voton në vend të tyre. Mirëpo, e arsyetojnë mënyrën e ndihmës ndaj më të moshuarve dhe personave analfabetë që votojnë, natyrisht sipas bindjes së tyre.

Kjo s'është e drejtë. Te ne nuk ka ndodhur kjo gjë. Mund të ndodhë ndonjëherë kur sidomos më të moshuarit nuk dinë shkrim lexim dhe për ata ka arsye që të kërkojnë ndihmë nga të tjerët, me kusht që të votojnë sipas mendimit të tyre.

Prej të anketuarve meshkuj vetëm njëri tha se i është ofruar që dikush tjetër të votoj në vendin e tij, gjë që e ka refuzuar. Rreth një e treta

janë në dijeni për raste të tilla, por janë të mendimit se në të shumtën e rasteve bëhet fjalë për të moshuar dhe analfabet ose për njerëz nga vendet e jashtme.

Unë kam dëgjuar se kreu i familjes ka votuar në emër të të gjithë anëtarëve të tjerë të familjes.

Mua personalisht nuk më ka ndodhur kjo gjë, por e di se në fshat ka shumë gra të cilat burrat i kanë në vende të huaja. Ashtu që ua marrin letërnjoftimet t'ju ndihmojnë gjatë votimit që të munden edhe ato ti përdorin votat e tyre.

Të jem i sigurtë se kjo gjë te ne shumë shpesh ndodh. Për shembull vjen kreu i familjes me 15 letërnjoftime dhe fillon të votojë.

Kam dëgjuar se një person voton për tjetrin, i cili ndodhet në vend të huaj.

Sipas komenteve, një numër i madh i të anketuarve meshkuj nuk e shohin të gabuar mënyrën që të votohet në emër të dikujt që gjendet në vend të huaj, ose është i moshuar, ose është analfabet. Në të gjitha rastet, deri diku e arsyetojnë votimin në emër të tjetrit.

5.1.6 Njohja e rregulloreve ligjore

Pjesa më e madhe e të anketuarve e dinë se votimi familjar dhe votimi në emër të tjetrit janë vepra penale. Më së paku të njohtuar me këtë ishin të anketuarit e Likovës. Megjithatë, vërehet kuptim i pamjaftuehëm i fenomenit dhe ngatërresa e kuptimeve (p.sh. votim familjar dhe thyerje e kutive të votimit)

Nuk kam dëgjuar për votim familjar, e di për thyerje dhe mbushje të kutive, por për votim familjar nuk kam dëgjuar. Supozoj se edhe kjo gjë dënohet me ligj.

E di që votimi familjar gjëhet, por e di se këtu kjo gjë është që t'ju ndihmohet të moshuarve që nuk hasin në ndihmesë nga personat zyrtarë të cilët janë të autorizuar t'ju ndihmojnë. Mendoj se këtu është problemi.

Edhe unë kam dëgjuar se gjëhet, por nuk e di konkretisht çka do të thotë kjo.

Megjithatë, askush nuk njih rast kur dikush ka qenë i gjobitur për votim familjar ose votim në emër të tjetrit. Ishin të përmendura raste kur

kanë qenë të vetëdijshëm se thyhet ligji para syve të tyre, por anëtarët e këshillit zgjedhor nuk kanë marrë masa për parandalim. Për shembull, në Shuto Orizare anëtarët e Këshillit zgjedhor asnjëherë nuk kanë paralamëruar se votimi familjar dhe votimi në emër të tjetrit është i ndaluar, sepse nuk kanë pasur mbrojtje dhe janë frikësuar. Poashtu, në Çelopezik ka ndodhur të vjen person i armatosur, i cili i është kërcnuar komisionit zgjedhor dhe i ka mbushur të gjitha kutitë zgjedhore, duke i injoruar anëtarët e Këshillit zgjedhor se atë gjë nuk guxon ta bëjë. Pastaj, ka pasur ndërprerje të zgjedhjeve në atë vend, ndërsa anëtarët e komisionit zgjedhor kanë mbetur të shokuar sepse nuk kanë qenë të mbrojtur.

Në përgjithësi, të anketuarit besojnë se gjobat mund të jenë mekanizëm efektiv për parandalimin e përsëritjes të këtyre veprimeve, por shprehin dyshim të madh në të qenit efikas në zbatimin e gjobave, për shkak të ndikimit që e kanë partitë mbi institucionet kompetente.

Kam dëgjuar për këtë gjë, mirëpo përsëri them, në atë ndikojnë edhe partitë politike dhe ndoshta prandaj asnjëherë nuk gjobiten.

Mendoj se pyetja është se sa gjobiten ata. Nëse dikush ndonjëherë ka qenë i gjobitur për prishjen e rendit zgjedhor, tani do të kishim situatë tërësisht të ndryshme, nuk flas vetëm për votimin familjar, por fjalën e kam edhe për parregullësi të tjera gjatë votimit. Përfundimisht nuk respektohen ligjet dhe mendoj se realisht askush nuk është i gjobitur për këtë.

Përderisa ka gjoba dhe ato funksionojnë efektivisht, nuk do të përsëriten rastet e tilla. Tani për tani mendoj se ligji nuk zbatohet.

Derisa ka përkrahje nga partia, ai person do të jetë në gjendje edhe disa herë ta përsërisë të njëjtën.

5.1.7 Mendime për arsyet e këtyre fenomeneve

Të anketuarit fajin kryesor për rastet e parregullësive zgjedhore e vendosin te partitë politike:

Përderisa vetë anëtarët e këshillave zgjedhore janë të afërt me partitë politike, kjo gjë do të ndodh. Fajtorët kryesorë të këtyre rasteve janë partitë dhe aktivistët e tyre.

por edhe te pushtetmbajtësit të cilët nuk bëjnë përpjekje të mjaftueshme që të tejkalohej kjo dukuri:

Qeveria është fajtores. Nëse duan ata nuk do të lejojnë të ndodh diçka. Edhe atyre ju konvenon të tregohet ndonjë grup i caktuar si problematikë.

Shteti është njësoj [fajtor] si dhe partitë politike, pa i ndarë të gjithë që u treguan të aftë në manipulimet.

Gjithashtu, disa e përmendën edhe mungesën e vullnetit të qytetarët që ta ndryshojnë këtë gjë dhe situatën e përgjithshme - varfërinë për shkak të cilës lëshohen në këtë lloj të parregullësive zgjedhore, me shpresë se në ardhmëri do të kenë ndonjë dobi. Sipas një pjese, vetë populli lejon të jetë i manipuluar nga ana e partive, më shumë për shkak arsimimit të pamjaftueshëm.

Unë mendoj se shkak më i madh të ne është analfabetizmi dhe injoranca e njerëzve, nuk dinë të lexojnë dhe nuk dinë kur është thënë se është e ndaluar.

Krahas kuptimit të përgjithshëm se shteti duhet të jetë më efikas për zgjidhjen e këtij problemi, ishte përmendur edhe roli i mediave:

Mendoj se mediat e kanë rolin kryesor, posaçërisht televizioni, ku duhet t'ua prezantojnë rregullat qytetarëve dhe të ketë më shumë ligjerata në lidhje me zgjedhjet.

Puna joefikase e këshillave zgjedhore llogaritet si pengesë plotësuese. Rrallë kush nga të anketuarit ka dëgjuar ndonjë anëtar të këshillave t'ju bëjë vërejtje votuesve të cilët votojnë në vend të tjetrit, përkundrazi, një numër i madh mendojnë se ata janë bashkëpjesëmarrës në këto veprime joligjore dhe poashtu duhet të gjobiten.

Unë mendoj se vetë anëtarët e këshillave janë të korruptuar, tolerojnë parregullësi dhe mendoj se ata së pari duhet të gjobiten.

Në një komision në të cilin isha i kyçur, kryetari i komisionit e fshehu votimin familjar që e bëri njëri prej bashkëpartiakëve të tij. Ne, anëtarët e tjerë të komisionit e ndalua procesin e atij votimi.

Unë mendoj se edhe vetë komisionet janë protagonistë të votimit familjar. Derisa ata e kishin parandaluar votimin familjar, kjo gjë nuk do të ndodhte.

Ishin të cekura disa mënyra për tejkalimin e këtyre problemeve: përmirësim i gjendjes ekonomike, sjellje e liderëve politik të rinj dhe stabil, zbatim më efikas i ligjeve dhe më shumë - ndryshim i mentalitetit me anë të arsimimit.

Unë do të thosha se duhet të ndryshon mentaliteti i qytetarëve, të rritet shkalla e njerëzve të arsimuar, ashtu që automatikisht do të ndryshojë edhe vetëdija.

Përderisa populli nuk vetëdijësohet se për cilin do të voton asgjë nuk do të ndryshon, për mua populli është ai i cili gabon dhe ansjërherë nuk do të ndryshohet.

Së pari duhet të implementohet ligji deri në fund, të gjobiten ata persona të cilët i kryejnë këto vepra, stërvitje për njerëzit që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për këtë segment, domethënë ndërtim i njëfarë vetëdijes tek qytetarët.

5.2 Vështrim i problemit të votimit familjar përmes prizmës së përfaqësuesve të institucioneve shtetërore

5.2.1 Problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit nga aspekti i KOZsë dhe këshillat zgjedhore

Intervistat e bëra me përfaqësuesin e KOZ-së dhe përfaqësuesit e këshillave zgjedhore tregojnë se edhe pse në një pjesë të pyetjeve për shkaqet e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, qëndrimet e tyre janë në pajtueshmëri, prapëseprapë ekzistojnë dallime në lidhje me propozimet për përballje me problemet.

Shkaqe për votim familjar dhe votim në emër të tjetrit

Problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, si mungesë e patejkalueshme e procesit zgjedhor është vërejtur në vitin 1998.¹² Kjo nuk do të thotë se në zgjedhjet e mëparshme deri në vitin 1998, procesi zgjedhor nuk ka qenë i prekur nga ky problem. Megjithatë, në fillim të viteve të 90-të, problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit ka qenë i errësuar për shkak të përparësive tjera më aktuale dhe problemeve, ndërsa poashtu duhet të theksohet se atëherë nuk është mbajtur evidencë si sot.¹³

Mentaliteti është i përmendur si një ndër shkaqet kryesore për paraqitjen e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, veçanërisht në vendet rurale. Pjesa më e madhe e popullatës në vendet rurale mendon se kjo gjë

12 Prof. dr. Renata Treneska-Deskoska, Një votues-një votë. Ta ndalojmë votimin familjar dhe votimin në emër të tjetrit, UNDP, 2008, fq. 5

13 Intervistë me Subhi Jakupin, nënkryetar i KOZ-së, 30.12.2008

është e natyrshme dhe është në kuadër të ligjit.¹⁴ Në këtë ndërlidhen edhe mendimet se ky fenomen nuk ka të bëjë vetëm me nivelin e ulët të vetëdijes për të drejtat personale nga ana e atyre votuesve, por edhe me pozitën patriarkale të familjeve të tyre, ku burri është ai që vendos.¹⁵ Shpeshherë, në prapavinë e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, fshihen interesat partiake, përkatësish qëllimi është të përfitohen sa më shumë vota, sepse mendojnë se në ardhmëri kjo gjë do të ju sjell ndonjë përfitim personal (p.sh. punësim).¹⁶ Në këtë drejtim i tërë konteksti politik dhe shoqëror ishin të përmendur si problematik nga aspekti i pamundësisë shteti të ballafaqohet me këtë problem, si dhe niveli i lartë i arsimimit të ulët të një pjesë e popullatës në vendet ku është vërejtur votim familjar dhe votim në emër të tjetrit.

Atë që e cekën përfaqësuesit e intervistuar të KQZ-së, ndër të gjitha ishin edhe kërcnimet që i dërgojnë të fuqishmit lokal, si dhe keqpërdorim i pozitave zyrtare e një pjese të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore. Janë të mendimit se në këtë mënyrë stimulohet votimi familjar dhe votimi në emër të tjetrit që të sigurohen vota të sigurta për ndonjë kandidat.

Mënyra të ballafaqimit me problemin

Komisioni qendror i zgjedhjeve nuk ka strategji konkrete për tejkalimin e këtij problemi. KQZ-ja në bashkëpunim me UNDP-në i qaset këtij problemi me anë të projekteve të tipit të ndryshëm që e trajtojnë këtë pyetje. Nga ana e KQZ-së, zgjidhje më e përshtatshme për këtë problem është gjetur në fushatat për rritjen e vetëdijes publike.

Ekziston vetëdija për pamundësinë e institucioneve relevante për ndalimin dhe çrënjosjen e këtij problemi. Megjithatë, përgjegjësia në masë më të madhe iu hidhet Këshillave zgjedhore¹⁷, duke marrë parasysh se deri më tani këshillat zgjedhore kanë dështuar në zbatimin adekuat të procesit zgjedhor në teren. Pjesa më e madhe e parregullësive zgjedhore është e fshehur pikërisht nga ata, që ka qenë shkak që institucionet zgjedhore të mos jenë në mundësi të veprojnë dhe ti gjobisin efektivisht shkaktarët e parregullësive zgjedhore. Opservim interesant i KQZ-së është se anëtarët femra të KQ-ve në mënyrë shumë më të përgjegjshme e kryejnë detyrën varësisht me meshkujt. Perceptimi i njëjtë ka të bëjë edhe me gratë përfaqësuese të partive politike që janë në vetë vendin e procesit zgjedhor.

14 Intervistë me Subhi Jakupin, nënkryetar i KQZ-së, 30.12.2008

15 Intervistë me përfaqësues të Këshillit zgjedhor, 12.01.2009

16 Ibid.

17 Ibid.

Nga ana tjetër, arsyetimi i këshillave zgjedhore se përse nuk kanë ndërmarrë masa ndërlidhet me frikën që e ndjejnë për shkak të incidenteve të deritanishme.¹⁸ Për këtë arsye mendojnë se ata që i nxisin incidentet kanë përkrahje prej disa strukturave shtetërore ose partiake, për çka nuk do të jenë të gjobitur, dhe në një situatë të tillë mund të pësoi vetëm ai që do t'i kundërshtoj.

Krahas vetëdijes së institucioneve shtetërore për rolin e madh të partive lidhur me këtë çështje, prapëseprapë ekziston optimizëm se partitë do të reformohen ndër presionin e numrit të madh të stërvitjeve dhe edukimit. Megjithatë, është e qartë se për çrënjosjen e këtyre problemeve dhe për transformim të mënyrës së partive në vetë ditën e zgjedhjeve është e nevojshme të ekziston zero tolerancë ndaj përfaqësuesve të tyre që në mënyra të ndryshme janë të përfshirë në parregullësitë zgjedhore. Si mekanizëm pozitiv në lidhje me kufizimin e hapësirës për provokim të parregullësive nga ana e përfaqësuesve politik, trajtohet përfaqësueshmëria e partive në këshillat zgjedhore. Duke pas prasysh se në këtë mënyrë partitë drejtpërdrejtë do ta vëzhgojnë procesin edhe përfaqësuesit e të gjitha partive do të jenë pjesë e KZ-ve, KQZ-ja pret zvogëlimin e parregullësive zgjedhore, siç është votimi familjar dhe votimi në emër të tjetrit.

Është e rëndësishme që partitë e përmendura si pjesë përgjegjëse, të reformohen dhe të demokratizohen përbrenda. Mjerisht, përfaqësuesit e këshillave zgjedhore¹⁹ që i kanë ndjekur problemet në teren frikësohen se motivimi kryesor i partive për stimulim të këtyre parregullësive është ta sigurojnë rezultatit e dëshiruar zgjedhor ose të realizojnë marrëveshje konkrete politike (veçanërisht në rast të zgjedhjeve presidenciale kur votat e shiptarëve janë posaçërisht të rëndësishme). Mendojnë se fitimi është shumë tërheqës për të fuqishmit politik dhe lokal që bëjnë „trampë“ për respektimin e parimeve kryesore të trupit zgjedhor demokratik, kur besojnë se do të kalojnë pa asnjë pasojë ligjore.

Është interesant të nënvizohet se gjobat nuk duhet të jenë mënyra e vetme dhe kryesore me të cilën do të zgjidhet ky problem.²⁰ Duhet pasur parasysh se insistim shumë intenziv i kësaj mënyre mund të rezultojnë me apstenim të një pjesë e trupit zgjedhor. KQZ-ja mendon se theksi duhet të vihet në edukimin veçanërisht të burrave të cilët duhet të jenë më fleksibël. Poashtu, për zgjidhjen e problemit të votimit familjar dhe votimit në emër

18 Intervistë me përfaqësues të Këshillit zgjedhor, 12.01.2009

19 Intervistë me përfaqësues të Këshillit zgjedhor, 12.01.2009

20 Intervistë me Subhi Jakupin, nënkryetar i KQZ-së, 30.12.2008

të tjetrit është e nevojshme gjobë efikase dhe kërkim i përgjegjësishë nga Këshillat zgjedhore si „rojtar“ kryesor dhe të drejtëpërdrejtë në procesin zgjedhor në teren. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet punës së Këshillave zgjedhore që edhe krahas zbatimit të trajnimeve dhe edukimeve të shumta, ende janë të nënshtruar në shtypje. Anëtarët e KQ-ve jo vetëm që duhet të gjobiten, por duhet të shkarkohen nëse nuk veprojnë drejtë, d.m.th. nëse përsëritet veprimi.

Në shumicën e rasteve, formati, më përkatësisht paqartësia e fletëvotimit është pretext për keqpërdorim. Deri më tani në KQZ nuk ka pasur kundërshtime zyrtare, përkatësisht sugjestionë se fletëvotimi është i paqartë dhe mund të jetë problem për kategorinë e votuesve analfabet.²¹ Edhe në lidhje me këtë pyetje, në KQZ dominon mendimi se rol kryesor duhet të kenë anëtarët e këshillit zgjedhor, të cilët duhet çdo votuesit i cili ka nevojë, t'ia spjegojnë procesin zgjedhor dhe t'i japin udhëzime në lidhje me fletëvotimin. Duhet pasur durim, si nga ana e anëtarëve të këshillave zgjedhore, ashtu edhe nga ana e votuesve.

Iniciativa e sektorit joqeveritar që ishte e paraqitur publikisht në lidhje me ekzistimin e vendeve të posaçme zgjedhore për meshkuj dhe femra, nuk has miratim të përfaqësuesit e KQZ-së. Mbizotëron mendimi se kjo gjë mund të jetë mënyrë e gabuar. Në këtë drejtim, nuk duhet të kërkohet arsyetim në shtrëngesat konkrete tradicionale dhe patriarkale, se burrat nuk i lejojnë gratë të shkojnë në vende ku ka burra tjerë. Problem i tillë mund të zgjidhet në mënyrë tjetër, si përsëmbull në këshillat zgjedhore në vende ku ekziston ky problem të ketë më shumë femra, pastaj gra përfaqësuese të KQ-ve t'ua spjegojnë procesin zgjedhor grave votuese etj. Përsëri, edhe në këtë pjesë KQZ-ja e përmend KQ-në si hallkë kryesore në procesin.

5.2.2 Problemi i votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit nga aspekti i deputeteve

Hulumtimet e shqyrtojnë edhe qëndrimin e deputeteve në lidhje me problemin e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit. Numri i përgjithshëm i deputeteve në bllokun shqiptarë të partive në përbërjen e tanishme parlamentare është 7, prej të cilave 5-ve iu dërgua listë me pyetje. Në fund, tre nga deputetet e kontaktuar e dhanë qëndrimin e vet në lidhje me shkaqet për votimin familjar dhe votimin në emër të tjetrit, problemet, si dhe zgjidhjet e mundshme.

Shkaqe për votim familjar dhe votim në emër të tjetrit

Lidhur me shkaqet për votim familjar, deputetet e intervistuar janë të njëzëshme se rol të madh luan mentaliteti patriarkal sipas të cilit kreu i familjes (babai, bashkëshorti, vjehri) vendos për tërë familjen, por edhe shpeshherë e plotëson të drejtën e votës. Kjo gjë është rezultat i paragjykitimeve dhe stereotipeve ekzistuese ndaj grave. Shpesh ndodhë që burrat votojnë në vendin e tyre ose ju sygjerorinë se për cilin të votojnë, veçanërisht kur bëhet fjalë për të rinj (posaqërisht ato që votojnë për herë të parë), por edhe për anëtarët më të moshuara të familjes. Në atë mënyrë, këtyre personave iu është marrë e drejta për votim individual, të drejtpërdrejtshëm dhe të fshehtë me çka do të kishin treguar qëndrimin dhe vullnetin e vet. Nga njëra anë, kategoritë e përmendura të grave janë shumë pasive, por nga ana tjetër janë tërësisht të injoruar kur bëhet fjalë për të drejtën e tyre zgjedhore. Në këtë kontekst, është përmendur edhe niveli i ulët i edukimit të votuesve, veçanërisht të votueset femra, që kontribuon për këtë situatë. Mjerisht, ato merren parasysh vetëm si numra të votave për çka vendosin burrat, me qëllim të sigurohen më shumë vota për qëllime konkrete politike.

Lidhur me votimin në emër të tjetrit keqpërdoret mungesa në vend e anëtarit të familjes ose nuk mund të del në votim për shkak të arsyeve objektive, më së shumti për shkak të bindjes në familje se ashtu duhet.

Në lidhje me faktin se ky është fenomen „i ri“ që nuk është vërejtur në zgjedhjet e viteve të më hershme të 90-të, deputetet mendojnë se në ciklet tona zgjedhore vërejmë tendencë të kundërt të kuptimit të praktikës së demokracisë. Në këtë drejtim mendojnë se nëse në fillimin e viteve të 90-të kemi pasur zgjedhje më të lira dhe më afër standardeve perëndimore, elitat politike është dashur ta përforcojnë dhe ta përsosin atë kulturë politike. Mirëpo, elitat duke u frikësuar nga vetëdija e qytetarëve dhe duke e parë atë si rrezik potencial për qeverisjen e tyre, në mënyrë të vetëdijshme i

tundën vlerat. Në këtë kontekst partitë janë të përmendura si fajtor kyresor, të cilët në vend që të ndërtojnë frymë të lirisë së zgjedhjes, ata e imponojnë zgjedhjen përmes kryetarëve lokal të partive të cilët vendosin në emër të lagjes, rrugës, fshatit etj.

Opservim interesant është se edhe pse deputetet janë anëtare të partisë politike, ato janë shumë kritike ndaj rolit të partive politike lidhur me votimin familjar dhe votimin në emër të tjetrit. Ato janë të mendimit se partitë politike janë ata që vendosën mënyrën e tillë të votimit dhe tani nuk mund të përballohen me problemin, as me konsekuencat që dalin prej tyre. Në këtë drejtim ishte potencuar se çrënjësja joefikase e këtij fenomeni shumë shpesh është në interes të partive politike dhe ato ndikojnë në këshillat zgjedhore që të tolerojnë këso lloj të parregullësive.

Në këtë kontekst rol negativ ka edhe pasiviteti i institucioneve shtetërore, të cilët nuk ndërmarrin asgjë ose masat që i ndërmarrin janë të parëndësishme dhe nuk kanë kapacitet për zgjidhjen e problemit për një afat më të gjatë. Në këtë kuptim, institucionet relevante shtetërore janë të përmendura si përgjegjëse sepse lejojnë hapësirë për këtë fenomen.

Mënyra e përballimit me problemin

Mjerisht, 2 prej deputeteve të intervistuar ndjejnë se në vendin tonë ende mbizotërojnë mendimet se “politika është punë burrash”. Mënyra e sigurtë për ndrrimin e këtij këndvështrimi është të inkurajohet pjesëmarrja e femrave në politikë. Është interesant të theksohet se janë të ndryshme mendimet e tyre për mënyrën e veprimit. Sipas mendimit të njëjës, kjo nuk është pyetje që me të vërtetë mund të zgjidhet me ndihmën e kuotave për përfaqësim në Kuvend, por përmes demokratizimit të procesit të nominimit të sa më shumë grave në bazat - në organizatat komunale dhe në bashkësitë lokale të partive. Është e rëndësishme se pikërisht aty duhet të filloj rekrutimi i sa më shumë grave për funksione politike, ndërsa partitë në programet e tyre duhet të ofrojnë projekte konkrete për përparimin e statutit të grave dhe t’i përsosin proceset për rekrutim. Nga ana tjetër, sipas mendimit tjetër, së pari është e domosdoshme strategjia nacionale, e cila do të zbatohet nga ana e institucioneve, ku rol kyresor mund të ketë OJQ sektori. Megjithatë, sipas këtij mendimi, është e rëndësishme nxjerrja e ligjit për pjesëmarrje proporcionale të grave në politikë dhe në institucionet tjera, posaçërisht në vende udhëheqëse të institucioneve shtetërore, si dhe implementim i të njëjtit përmes mekanizmeve të përforcuara kontrolluese. Mbase, është i nevojshëm organizimi i fushatave të ndryshme dhe seminareve për ngritjen e vetëdijes publike të popullatës dhe ngritjen e arsimit dhe edukimit të femrave.

Të gjitha deputetet e intervistuar si zgjidhje më efektive e përmendin arsimimin e grave në vendet ku është i pranishëm ky fenomen. Në këtë drejtim, është e nevojshme që në shkollat e mesme të zbatohen programe edukative lidhur me demokracinë, zgjedhjet, e drejta dhe liria e zgjedhjes si shtyllë elementare e demokracisë. Konkludimi nga kjo është se sa më tepër gruaja është e arsimuar, mundësitë për manipulim me votën e saj janë më të vogla. Përveç arsimimit formal, përmendet edhe nevoja për organizimin e fushatave dhe seminareve për ngritjen e vetëdijes, se gratë nuk duhet të jenë votuese pasive dhe inerte ndaj rrjedhave shoqërore.

Në masë të caktuar edhe fletëvotimi mund të konsiderohet si problem dhe i papërshtatshëm për trupin zgjedhor analfabet. Në këtë drejtim dy prej deputeteve të intervistuar mendojnë se fletëvotimi është i komplikuar për këtë kategori të votuesve.

Është interesant se mendimet janë të ndara lidhur me idenë se në vende të caktuara ku në kontinuitet janë të vërejtura këto probleme, burrat dhe gratë duhet të votojnë në vende të ndara votuese. Nga njëra anë, kjo zgjedhje konsiderohet si e papërshtatshme për Maqedoninë, e cila synon kah një shoqëri e vërtetë dhe funksionale demokratike. Prej këtu, flitet për nevojën se liderët politik dhe vetë partitë politike duhet të tregojnë vullnet politik se në ditën e zgjedhjeve do të votojnë qytetarët, e jo militantët dhe agjitorët politik, ose kryetarët lokal, siç ka qenë deri më tani. Nga ana tjetër, një deputete tjetër mendon se kjo mund të jetë metodë e mirë për ndërprerjen e ndikimit të burrave. Në atë mënyrë mund të kontribuohet që gratë të jenë më aktive në nxerrjen e vendimeve.

6

REKOMANDIME

Rekomandime për mediat

- Kushtueshmëri dhe kujdes më i madh ndaj fenomeneve të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit, posaçërisht para zgjedhjeve.
- Shqyrtim i problemit nga më shumë aspekte, në vend të prezantimit stereotip.
- Ndikim edukativ mbi votuesit përmes njohtimit me rregullat e votimit.

Rekomandime për partitë politike

- Edukim i anëtarëve të tyre për problemin e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit.
- Anëtarët-femra të partive politike të kontribuojnë përmes projekteve dhe inicijativave të ndryshme (donator të huaj, inicijativa personale etj.) për ngritjen e vetëdijes të popullatës kundër votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit.
- Kontrollim më i madh mbi të gjithë rradhët e partisë para dhe pas periudhës zgjedhore.
- Nxitja e votuesve të dalin në zgjedhje përmes garantimit të sigurisë, në vend të frikësimit dhe kërcnimit.
- Gjatë fushatës zgjedhore ta marrin parasysh problemin e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit dhe t'i ftojnë votuesit të mos i nënshtrohen presioneve.

Rekomandime për pushtetin qendror

- Përgatitje e strategjisë nacionale për ballafaqim me problemet e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit.
- Edukim i votuesve dhe votuesve potencial për votim të drejtë. Të ndiko-

het posaçërisht mbi tejkalimin e stereotipeve se 'kreu i familjes' duhet të udhëheq me votat e anëtarëve tjerë të familjes; reagim në raste kur dikush tenton t'i thyen të drejtat e tyre si votues etj.

- Trajnim për anëtarët e këshillave për mënyrat e përballimit me parregullësitë zgjedhore.
- Përfaqësim më i madh i grave në këshillat zgjedhore, posaçërisht në rajonet e rrezikshme.
- Inkuadrim i të gjitha institucioneve shtetërore në aktivitete më intenzive me qëllim të arritjes së barazisë më të madhe ndërmjet gjinive.
- Fushatë e përforcuar në nivel nacional për ngritjen e vetëdijes publike.
- Kontrollë më të madhe e ngjarjeve në vendet zgjedhore përmes vendosjes së mbikqyrësve dhe organeve të rendit gjatë tërë procesit zgjedhor.
- Efektuim i gjobave për votimin familjar dhe votimin në emër të tjetrit.
- Marrëveshje me partitë politike për përgjegjësinë e tyre para dhe gjatë zbatimit të zgjedhjeve.
- Vendosje e të ashtuquajturës "linjë e nxehtë" në të cilën qytetarët do të mund anonimisht ti paraqesin kërccnimet dhe parregullësitë gjatë zgjedhjeve.

Rekomandime për donatorët

- Kornizë (strategji) e qartë gjenerale e projekteve të financuara në këtë sferë që do të ketë kontinuitet dhe nuk do të jetë e fokusuar vetëm gjatë cikleve zgjedhore.
- Definim më real i afateve, mjeteve financore dhe „tajming i mirë“ kur bëhet fjalë për projekte që duhet të kenë ndikim të vërtetë në teren.
- Evaluim cilësor para dhe pas përbushjes së strategjisë të donatorëve në lidhje me efektet e arritura në teren.

7

PËRFUNDIM

Analiza udhëzon në disa faktorë kryesorë për problemin e votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit. Ajo çka mund të vërehet nga përvojat e grupeve të ndryshme të shqyrtuara, udhëzon në përputhshmëri rreth shkaqeve kryesore për shfaqjen e këtij fenomeni. Si deri më tani, mentaliteti në vende të caktuara është theksuar si një ndër faktorët kryesor, mirëpo poashtu i rëndësishëm paraqitet edhe roli i institucioneve konkrete (këshillat zgjedhore dhe partitë), si dhe statuti arsimor i trupit zgjedhor. Prej këtui, është e qartë se strategjia për zgjidhjen e këtij problemi duhet të arrijë të disa grupe të caktuara, përmes përdorimit të mënyrave dhe „mjeteve“ të ndryshëm.

Nga ky hulumtim dalin disa grupe të caktuara që duhet të merren në konsiderim:

- Personat të cilët jetojnë në vende ku problemi i votimit familjar dhe votimi në emër të tjetrit janë të vërejtura në kontinuitet (Në këtë pjesë është e rëndësishme të potencohet se mënyra nuk do të jetë e suksesshme nëse grup i caktuar janë vetëm gratë në ato vende. Përkundrazi kujdes i madh duhet t'ju përkushtohet burrave si faktor kryesor për tejkalimin e shtrëngesave tradicionale që në raste të caktuara e nxisin problemin).
- Partitë politike
- Përfaqësuesit e Këshillave zgjedhore

Në këtë drejtim duket të shfrytëzohen më shumë mënyra që të arrihet deri te grupet e caktura. Rol kryesor në këtë pjesë duhet të luajnë mediat të cilët duhet të përkushtojnë më shumë kohë dhe ti qasen problemit më thellësisht. Në këtë drejtim do të ishte e dobishme përdërisa ky problem trajtohet në kontinuitet, e jo vetëm gjatë zgjedhjeve. Në këtë drejtim mund të jetë i mirëseardhur edhe bashkëpunimi me OJQ sektorin.

Kur përmendet OJQ sektori paraqitet një problem tjetër. Ndihet mungesë e madhe në mënyrën e donatorëve të cilët financojnë projekte nga kjo lëmi. Shpeshherë projektet pësojnë nga korniza e papërshtatshme kohore në të cilën pritet të zbatohen qëllime konkrete ambicioze, si edukimi ose ngritja e vetëdijes; mungesë e kontinuitetit në mënyrën e ngritjes së vetëdijes; mungesë e kohës së mjaftueshme për vlerësimin e situatës dhe përgatitjes së materialeve; mungesë e mjeteve financiare për zbatimin e fushatës cilësore; mungesë e lidhshmërisë së projekteve në një kornizë strategjike më të përgjithshme etj. Nga ana tjetër, problematike është edhe mënyra e OJQ sektorit. Kur bëhet fjalë për fushata për ngritjen e vetëdijes, është e nevojshme dijeni dhe mënyrë e definuar metodologjike për arritjen e efekteve të vërteta. Mjerisht, në përgjithësi kapaciteti i OJQ sektorit është i dobët për t'iu përgjigjur kësaj detyre, duke e barazuar këtë tip fushatash me aktivitete që shumë pak ose aspak nuk ndikojnë në ngritjen e vetëdijes.

Rol të madh në ngritjen e vetëdijes së popullatës mund të luajnë gratë e inkuadruara në politikë, përmes të cilave duhet drejtpërdrejtë të transmetohet porosia në teren. Është i nevojshëm inkuadrim aktiv dhe më i dukshëm i deputeteve, grave anëtare të partive politike, përfaqësuesve të OJQ sektorit në projektet dhe iniciativat nga institucionet relevante shtetërore dhe donatorët e jashtëm, të cilat do të jenë pjesë e strategjisë së qartë dhe në kontinuitet për çrënjosjen e këtyre problemeve.

Për zgjidhjen e problemit të votimit familjar dhe votimit në emër të tjetrit është i nevojshëm ndryshim i kontekstit të përgjithshëm shoqëror dhe politik. Në këtë drejtim i rëndësishëm është ballafaqimi i përgjithshëm i problemit, që përfshin funksionim të mirë të shtetit ligjor, strategji të qartë për përparimin e nivelit të arsimimit të grupeve të cekura, përmirësim i gjendjes së tyre ekonomike etj.

